



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VI
Sesioni pranveror

Kryesia e Kuvendit

P-032

Prishtinë, më 31 maj 2018, në orën 09:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

PROCESVERBAL

IMBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, E MBAJTUR MË 31 MAJ 2018

Në mbledhje morën pjesë: Kadri Veseli, kryetar i Kuvendit; Kujtim Shala, Aida Dërguti dhe Slavko Simiq, nënkryetarë të Kuvendit.

Nga grupet parlamentare: Avdullah Hoti, Memli Krasniqi, Albulena Haxhiu, Dardan Sejdiu, Ahmet Isufi, Bilall Sherifi dhe Albert Kinolli.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

Nga Kabineti i kryetarit të Kuvendit: Avni Bytyqi.

Nga Administrata e Kuvendit: Ismet Krasniqi, Xheladin Hoxha, Sali Rexhepi, Shefki Shoshaj dhe Musli Krasniqi.

Nga EUSR-ja: Blerta Bejtullahu,

Nga NDI-ja: Shefki Kastrati,

Nga OSBE-ja: Zoja Nushi.

Mbledhjen e kryesoi Kadri Veseli, kryetar i Kuvendit.

Kryetari e hapi mbledhjen dhe i njoftoi të pranishmit me propozimin e rendit të ditës.

Kryesia, me propozimin e kryetarit, i zhvilloi punimet me këtë:

Rend dite

1. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e mëparshme të Kryesisë së Kuvendit,
2. Vazhdimi i seancës plenare me pikat e papërfunduara më 17 dhe 30 maj 2018,
3. Përgatitjet për seancë plenare të radhës dhe
4. Shqyrtimi i propozimeve dhe kërkesave.

1. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e mëparshme të Kryesisë së Kuvendit

Kryesia i miratoi pa vërejtje procesverbalet e mbledhjeve të Kryesisë, të mbajtura më 14 dhe 17 maj 2018.

2. Vazhdimi i seancës plenare me pikat e papërfunduara më 17 dhe 30 maj 2018

Kryetari i njoftoi të pranishmit me pikat e papërfunduara nga seanca plenare e mbajtur më 17 dhe 30 maj 2018.

Kryesia, me propozim të kryetarit, vendosi që seanca plenare me pikat e papërfunduara më 17 dhe 30 maj 2018 t'i vazhdojë punimet të premtën, më 1 qershor 2018, në orën 13:00, me këtë rend dite:

Rend dite

1. *Shqyrtimi i raportit vjetor të Institucionit të Avokatit të Popullit për vitin 2017,*
2. *Votimi i rezolutës nga debati parlamentar në lidhje me të drejtat e punëtorëve dhe adresimin e papunësisë në Republikën e Kosovës, sipas kërkesës së GP të LVV,*
3. *Debat parlamentar në lidhje me zbatimin e Marrëveshjes ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Shqipërisë për unifikimin e pikave doganore ndërmjet tyre, sipas kërkesës së deputetit Visar Ymeri, mbështetur edhe nga 11 deputetë,*
4. *Debat parlamentar në lidhje me kartonin e gjelbër, sipas kërkesës së deputetit Faton Topalli, mbështetur edhe nga 11 deputetë,*
5. *Debat parlamentar në lidhje me gjendjen jo të mirë të rinisë kosovare, sipas kërkesës së deputetit Fidan Rekalii, mbështetur edhe nga 5 deputetë.*

3. Përgatitjet për seancën plenare të radhës

Kryetari i njoftoi të pranishmit me pikat e rendit të ditës që i plotësojnë kushtet formale për shqyrtim në seancë të re plenare.

Me propozim të deputetes Albulena Haxhiu, në emër të GP të LVV-së dhe me pëlqim të GP të LDK-së, Kryesia e Kuvendit vendosi që seanca plenare e radhës t'i zhvillojë punimet vetëm me interpelancat e parashtruara për kryeministrin e Kosovës.

Kryesi e Kuvendit, me propozim të kryetari të GP të LDK-së, z. Avdullah Hoti, vendosi që tri projektligjet: Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 05/L-028 për tatimin në të ardhurat personale; Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.05/L-029 për tatimin në të ardhurat e korporatave; Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.05/L-037 për Tatimin në Vlerën e Shtuar, të radhiten në rend dite të seancës plenare më 14 qershor 2018.

Kryesia, me pëlqimin e kryetarëve të grupeve parlamentare, vendosi që Kuvendi gjatë ditëve në vijim t'i mbajë tri seanca plenare, si në vijim.

I. Seanca plenare të hënën, më 4 qershor 2018, në orën 10:00, me këtë:

Rend dite

1. *Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,*
2. *Koha për pyetje parlamentare,*
3. *Miratimi i procesverbalit nga seanca plenare e mëparshme,*
4. *Interpelanca e kryeministrit të Republikës së Kosovës, z. Ramush Haradinaj, sipas kërkesës së GP-LVV dhe të GP të LDK në lidhje me situatën dhe gjendjen financiare në ndërmarrjet publike të Telekomit dhe të Postës së Kosovës,*
5. *Interpelanca e Kryeministrit të Republikës së Kosovës, z. Ramush Haradinaj, sipas kërkesës së GP- LDK, në lidhje me vendimet e ministrit të Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, z. Nenad Rikalo për shkarkimin e një drejtori dhe ndarjen e mjeteve grante dhe subvencione,*
6. *Shqyrtimi i parë i Projekt-kodit Penal të Republikës së Kosovës,*
7. *Shqyrtimi i parë i Projektligjit për institucionet mikrofinanciare dhe institucionet financiare jobankare,*
8. *Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-179 për transportin rrugor,*
9. *Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-183 për transportin tokësor të mallrave të rrezikshme,*

10. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 05/L-088 për rregullat e trafikut rrugor,
11. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 05/L-064 për patentë shoferi,
12. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2003/11 për rrugë, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 03/L-120,
13. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-063 për hekurudhat e Kosovës,
14. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për aktet juridike,
15. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Kompleksin Memorial “Adem Jashari” në Prekaz,
16. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 02/L-31 për lirinë fetare në Kosovë,
17. Shqyrtimi i raportit të Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale në lidhje me mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për shërbime sociale dhe familjare dhe Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për shërbime sociale dhe familjare,
18. Shqyrtimi i raportit vjetor të Agjencisë Kundër Korrupsionit për vitin 2017,
19. Shqyrtimi i raportit vjetor të Autoritetit Kosovar të Konkurrencës për vitin 2017,
20. Shqyrtimi i raportit vjetor të statistikave zyrtare për vitin 2017,
21. Shqyrtimi i raportit vjetor të Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik për vitin 2017,
22. Shqyrtimi i raportit vjetor të Organit Shqyrtues të Prokurimit për vitin 2017,
23. Shqyrtimi i raportit vjetor të Akademisë së Drejtësisë për vitin 2017,
24. Shqyrtimi i Projekt-platformës shtetërore për finalizimin e dialogut ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet dy vendeve,
25. Zgjedhja e drejtorit të Agjencisë për Menaxhimin e Komplekseve Memorialë të Kosovës,
26. Emërimi i një (1) anëtari të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës,
27. Formimi i Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për një (1) anëtar të Komisionit të Pavarur të Medieve nga radhët e komuniteteve joshumicë,
28. Propozimi i grupeve parlamentare për zëvendësimin e anëtarëve në komisionet parlamentare.

II. Seanca plenare tjetër e radhës mbahet të enjten, më 14 qershor 2018, në orën 10:00, me këtë:

Rend dite

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.05/L-028 për tatimin në të ardhurat personale,

- 4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.05/L-029 për tatimin në të ardhurat e korporatave,*
- 5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.05/L-037 për tatimin në vlerën e shtuar,*
- 6. Propozimi i Grupit Parlamentar të Partisë Socialdemokrate për formimin e Komisionit Hetimor Parlamentar në lidhje me emërimet e shërbyeseve të lartë civilë në Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës,*
- 7. Propozimi i Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës, mbështetur edhe nga deputetët tjerë nënshkrues, për formimin e Komisionit Hetimor Parlamentar, në lidhje me ndriçimin e rastit të dëbimit të gjashtë shtetasve turq më 29 mars 2018,*
- 8. Debat parlamentar në lidhje me Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve 2019-2021.*

Gjithashtu, Kryesia vendosi që ky rend i ditës mundet të plotësohet ndërkohë edhe me pika tjera që i plotësojnë kushtet për procedim.

III. Seanca solemne do të mbahet të dielën, më 10 qershor 2018, në orën 10:00, në Kompleksin Monumental të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, në Prizren me këtë:

Rend dite

- 1. Shënimi i 140-vjetorit të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit.*

4. Shqyrtimi i propozimeve dhe kërkesave

- 1. Procedimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 05/L-132 për automjete*

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me procedimin e Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 05/L-132 për automjete, nxori këtë:

P Ë R F U N D I M

1. Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 05/L-132 për Automjete u shpërndahet deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës.
2. Ngarkohet Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal, si komision funksional, që ta shqyrtojë Projektligjin në parim dhe Kuvendit t'ia paraqesë raportin me rekomandime, para shqyrtimit të parë në seancë plenare.

- 2. Procedimi i Projektligjit për shqyrtimin dhe vërtetimin e pasurisë së pajustifikueshme*

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me procedimin e për shqyrtimin dhe vërtetimin e pasurisë së pajustifikueshme, nxori këtë:

P Ë R F U N D I M

1. Projektligji për shqyrtimin dhe vërtetimin e pasurisë së pajustificueshme u shpërndahet deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

2. Ngarkohet Komisioni për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe mbikëqyrjen e Agjencisë kundër Korrupsionit si komision funksional, që ta shqyrtojë Projektligjin në parim dhe Kuvendit t’ia paraqesë raportin me rekomandime, para shqyrtimit të parë në seancë plenare.

3. Propozimi i Grupit Parlamentar të Partisë Socialdemokrate për formimin e Komisionit Hetimor Parlamentar në lidhje me emërimet e shërbyeseve të lartë civilë në Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës

Kryesia propozimin e lartshënuar e radhiti në rend dite për seancën plenare, më 14 qershor 2018.

4. Propozimi i Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës, mbështetur edhe nga deputetët tjerë nënshkrues, për formimin e Komisionit Hetimor Parlamentar në lidhje me ndriçimin e rastit të dëbimit të gjashtë shtetasve turq më 29 mars 2018

Kryesia propozimin e lartshënuar e radhiti në rend dite për seancën plenare, më 14 qershor 2018.

5. Shqyrtimi i kërkesës së Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës për debat parlamentar në lidhje me Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve, 2019-2021

Kryesia kërkesën e lartshënuar e radhiti në rend dite për seancën plenare, më 14 qershor 2018.

6. Shqyrtimi i kërkesës së Komisionit për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media në lidhje me objektin e Radio Kosovës

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me kërkesën e lartshënuar, nxori këtë:

P Ë R F U N D I M

Qeveria e Republikës së Kosovës ta shqyrtojë kërkesën e Komisionit për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media, në lidhje me objektin e Radio Kosovës.

7. Kërkesat e grupeve parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje dhe të Partisë Socialdemokrate lidhur me ri-ndarjen e komisioneve parlamentare të Kuvendit

Kryesia, propozimet e grupeve parlamentare të LVV-së dhe PSD-së për zëvendësimin e anëtarëve në komisionet parlamentare, e radhiti në rend dite për seancën plenare, më 4 qershor 2018.

8. Shqyrtimi i kërkesës së kryetares së Komisionit për Punë të Jashtme, Diasporë dhe Investime Strategjike, Vjosa Osmani Sadriu për lejimin e udhëtimit zyrtar në Lituani

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

V E N D I M

Kryetares së Komisionit Punë të Jashtme, Diasporë dhe Investime Strategjike, znj. Vjosa Osmani-Sadriu i lejohet udhëtimi zyrtar në Vilnius (Lituani), nga 5-9 qershor 2018.

9. Shqyrtimi i kërkesës së kryetares së Komisionit për Integrime Evropiane Blerta Deliu-Kodra për lejimin e udhëtimit zyrtar në Sofje (Bullgari)

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

V E N D I M

Deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës: Blerta Deliu-Kodra dhe Armend Zemaj u lejohet udhëtimi zyrtar në Sofje (Bullgari), nga 17-19 qershor 2018.

10. Shqyrtimi i kërkesës së deputetit Armend Zemaj për lejimin e udhëtimit zyrtar në Gjermani

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

V E N D I M

Deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës: Armend Zemaj, Blerta Deliu-Kodra dhe Donika Kadaj-Bujupi u lejohet udhëtimi zyrtar në Berlin (Gjermani), nga 13-17 qershor 2018.

11. Shqyrtimi i kërkesës së deputetit Naser Rugova për ndryshimin e vendimit lidhur me lejimin e udhëtimit zyrtar në Gjermani

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, vendosi deputetit Naser Rugova t'i lejohet udhëtimi zyrtar në Berlin (Gjermani), prej 13 deri më 17 qershor 2018.

12. Shqyrtimi i kërkesës së deputetit Veton Berisha për lejimin e udhëtimit zyrtar në Gjermani

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

V E N D I M

Deputetit të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Veton Berisha i lejohet udhëtimi zyrtar në Gjermani, nga 2-4 qershor 2018.

13. Shqyrtimi i kërkesës së Komisionit për Punë të Jashtme, Diasporë dhe Investime Strategjike në lidhje me miratimin e kërkesave për realizimin e vizitave zyrtare jashtë vendit të këtij Komisioni

Kryetari konstatoi se kërkesat e Komisionit për Punë të Jashtme, Diasporë dhe Investime Strategjike, në lidhje me udhëtimet zyrtare jashtë vendit do të shqyrtohen në bazë të procedurave të papara për lejimin e udhëtimeve zyrtare jashtë vendit.

14. Shqyrtimi i kërkesës për mbulimin e shpenzimeve me rastin e vizitës të delegacionit nga Parlamenti i Kroacisë, në Kosovë, prej 27-29 maj 2018

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

V E N D I M

Miratohet kërkesa për mbulimin e shpenzimeve të akomodimit, si dhe shpenzimeve tjera me rastin e pritjes së delegacionit nga Parlamenti i Kroacisë për vizitën e realizuar në Kosovë, nga 27-29 maj 2018.

15. Shqyrtimi i kërkesës së Shoqatës së të Verbërve të Kosovës për mbështetje financiare

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

V E N D I M

Shoqata e të Verbërve të Kosovës mbështetet financiarisht në shumën prej 4 332,24 euro për shtypjen në alfabetin Brail të tre (3) ligjeve dhe për sesionet informuese për këto ligje.

16. Shqyrtimi i kërkesës së Shoqatës së familjarëve të personave të pagjetur “Zëri i prindërve” në Mitrovicë për mbështetje financiare

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

V E N D I M

OJQ-ja Zëri i Prindërve mbështetet financiarisht në shumën prej 3 500 euro për aktivitetet e veprimtarisë së kësaj OJQ-je, që kanë të bëjnë me personat e pagjetur.

17. Shqyrtimi i kërkesës së Lidhjes së Shkrimtarëve të Kosovës për mbështetje financiare

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

V E N D I M

Lidhja e Shkrimtarëve të Kosovës mbështetet financiarisht në shumën prej 5 000 euro për organizimin e Festivalit Ndërkombëtar të poezisë “Drini Poetik”

18. Shqyrtimi i kërkesës së Shoqatës për emancipimin e femrës “Alma” për mbështetje financiare

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

V E N D I M

Shoqata për emancipimin e femrës ALMA mbështetet financiarisht në shumën prej 1 500 euro për financimin e projektit “Urat e barazisë gjinore” .

19. Shqyrtimi i kërkesës së Shoqatës së personave me aftësi të kufizuara Handikos - Drenas për mbështetje financiare

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

V E N D I M

Shoqata e personave me aftësi të kufizuara Handikos Drenas mbështetet financiarisht në shumën prej 3 500 euro për financimin e projektit “Kampi rehabilitues vero 2018 i personave me aftësi të kufizuara”.

20. Shqyrtimi i kërkesës së z. Emin Cakiqi për mbështetje financiare

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

V E N D I M

Z. Emin Cakiqi, nga fshati Tërstenik, Komuna e Glllogocit, mbështetet financiarisht në shumën deri në 1 000 euro për blerjen e një injeksioni për kurimin e tij nga sëmundja e syve, sipas faturës.

21. Njoftimi lidhur me kërkesën e GP të LVV drejtuar Presidentit të Republikës së Kosovës për anulimin e Vendimit të Kuvendit të Kosovës në lidhje me propozimin e z. Radomir Laban për gjyqtar të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës

Kryesia u njoftua me shkrim lidhur me kërkesën e lartshënuar.

22. Njoftimi i Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, për Persona të Pagjetur dhe Peticione lidhur me realizimin e vizitës zyrtare në Shqipëri

Kryesia e me shkrim nga Komisioni i lartshënuar për realizimin e vizitës zyrtare në Shqipëri, nga 13-16 prill 2018.

23. Njoftimi i Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal lidhur me realizimin e udhëtimit zyrtar në Belgjikë

Kryesia u njoftua me shkrim nga Komisioni i lartshënuar lidhur me realizimin e udhëtimit zyrtar në Belgjikë, më 24 prill 2018.

24. Njoftimi i Kryetares së Komisionit për Integritet Evropian, Blerta Deliu-Kodra lidhur me realizimin e udhëtimit zyrtar në Luksemburg

Kryesia u njoftua me shkrim nga kryetarja e Komisionit për Integritet Evropian, Blerta Deliu-Kodra, lidhur me realizimin e udhëtimit zyrtar në Luksemburg, nga 2 - 3 maj 2018.

* * *

Pikat shtesë:

1. Propozimi për një shtesë vjetore për nëpunësit e Administratës së Kuvendit

Kryesia, pasi e shqyrtoi propozimin e lartshënuar, vendosi që të punësuarve në Kuvendin e Republikës së Kosovës për angazhim të shtuar jashtë orarit të punës dhe për performacën e treguar për gjashtëmujorin e parë të vitit 2018 në mbështetjen e trupave punues të Kuvendit: Kryesisë së Kuvendit, seancës plenare dhe komisioneve parlamentare, t'iu bëhet një kompensim.

2. Ndarja e veturave për kryetarë të grupeve parlamentare

Kryesia, pasi diskutoi për ndarjen e veturave për kryetarët e grupeve parlamentare, mori këtë:

V E N D I M

Për ndarjen e veturave

1. Veturat e siguruar përmes Agjencisë Qendrore të Prokurimit u ndahen për shfrytëzim nga një (1) veturë për secilin grup parlamentar, një (1) veturë për Kabinetin e kryetarit të Kuvendit dhe një (1) veturë për ish-kryetarin e Kuvendit, z. Jakup Krasniqi.

2. Kuvendi për shfrytëzimin e veturave nga grupet parlamentare nuk merr përsipër asnjë lloj shpenzimi.

3. Shfrytëzimi i veturave lidhet me mandat dhe dorëzohen në ditën e pezullimit të punës së Kuvendit, ose ditën e shpërndarjes.

3. Propozim-vendimi për plotësimin e organogramit të Administratës së Kuvendit

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me plotësimin e organogramit të Administratës së Kuvendit, vendosi që të plotësohet edhe me katër (4) pozita për edukimin e të rinjve lidhur me punën e Kuvendit.

4. Kërkesa e Zyrës së Presidentit të Kosovës për zyra pune për presidentin që i ka kaluar mandati

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, nxori këtë:

P Ë R F U N D I M

Kuvendi i Republikës së Kosovës nuk ka hapësira (zyra) për dhënien në shfrytëzim për Zyrën e Presidentit të Republikës së Kosovës.

Kryetari e mbylli mbledhjen e Kryesisë së Kuvendit në orën 10:05 minuta.

Kryetari i Kuvendit

Kadri VESELI

Procesverbalin e hartoi:

Drejtorja për Çështje Plenare dhe Procedurale